

V E N D I M
Nr. 672, datë 15.12.2000

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 766, DATË 8.12.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE, USHTARAKE, TË RËNDËSISË SË VEÇANTË,"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8, të ligjit nr. 8478, datë 13.5.1999, "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr. 766, datë 8.12.1998, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në paragrafin e dytë të pikës 1, fjalët "...deri në dy vjet" ndryshohen dhe zëvendësohen me fjalët "...deri më 31.12.2001".

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

"Pagesën e gadishmërisë e përfitojnë 1160 punonjës të Kombinatit Mekanik në Poliçan, 100 punonjës të Uzinës së Lëndëve Plasëse në Mjekës, 70 punonjës të Uzinës Mekanike në Gramsh, dhe 20 punonjës të Uzinës së Pilave në Gramsh. Në rastet kur këta punonjës largohen për efekt të daljes në pension ose shkëpusin marrëdhëniet me ndërmarrjet për shkak të vendbanimit familjar ose për arsye të tjera, të mos zëvendësohen me punonjës të tjerë."

3. Pika 4 ndryshohet si vijon:

"Rritja e masës së pagesës së këtyre punonjësve të bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës."

4. Pika 6 ndryshohet si vijon:

"Periudha e pagesës së punonjësve, sipas këtij vendimi, vlerësohet periudhë sigurimi. Kontributet për sigurimet shoqërore për këta punonjës përballohen nga buxheti i shtetit."

5. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1, me këtë përmbajtje:

"Efektet financiare për pagesën dhe kontributet për sigurimet shoqërore të punonjësve të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale."

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta